



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

Dokument parlamentar

Tiranë, më _____ 2018

RAPORT PËR PROJEKTKODIN E SJELLJES SË DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

(Raport i shumicës parlamentare në Këshill)

- HYRJE

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në cilësinë e organit përgjegjës, në mbështetje të nenit 13 të Rregullores së Kuvendit, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit z. Gramoz Ruçi, në mbledhjet e datave 17 tetor 2017 dhe 19 janar 2018 mori në shqyrtim projektvendimin “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë”.

- BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Projektvendimi është nisëm e një grupi deputetësh, depozituar në Kuvend në legjislaturën e kaluar dhe ridepozituar më 4 tetor 2017. Projektkodi është hartuar në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe neneve 40, pika 3 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit.

Sipas nenit 75, pika 2 të Kushtetutës

“Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”.

Sipas nenit 40, pika 3 të Rregullores

“Anëtarët e Kuvendit, gjatë veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Sjelljes”, ndërsa

Sipas nenit 117 të Rregullores së Kuvendit

“Çdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit”.

Projektkodi propozohet si aneksi nr. 2 i Rregullores së Kuvendit. Për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 13, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, organi përgjegjës për të diskutuar propozimet për ndryshimin e Rregullores është Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTVENDIMIT TË PROPOZUAR

Projektkodi i Sjelljes organizon kuadrin etik të Kuvendit të Shqipërisë në një dokument të vetëm dhe gjithëpërfshirës: ai ofron rregulla dhe udhëzime për deputetët se si të veprojnë në raste të caktuara për zgjidhjen e dilemave etike dhe për adresimin dhe parandalimin e konflikteve të interesit. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se ajo që shpesh është e lejuar me ligj, nuk mund të jetë domosdoshmërisht etike. Në këtë drejtim Kodi siguron qartësi në këto lloj çështjesh duke identifikuar edhe mënyrat e veprimit të shërbimeve të Kuvendit në funksion të deputetëve.

Projektkodi i propozuar synon të ndihmojë deputetin të ushtrojë detyrën e saj/tij duke përcaktuar rregullat sipas standardeve të duhura të sjelljes dhe forcimin e kulturës së integritetit gjatë kohëzgjatjes së mandatit; të mundësojë veprimtarinë e deputetit në një mjedis bashkëpunues e besimi reciprok; t'i mundësojë deputetit të zgjedhë drejtimin e duhur të sjelljes në situata të ndryshme të dilemës etike për ta mbrojtur ndaj presioneve të pahijshme; të nxisë transparencën e veprimtarisë së deputetit dhe përgjegjshmërinë e tij për të forcuar besimin tek publiku.

Projektkodi i Sjelljes është i strukturuar në 4 krerë. Ai mbulon çështjet si: Fusha e veprimit, parimet e përgjithshme, detyrat e deputetit, sjelljen në kuvend, gjuhën joparlamentare dhe diskriminuse, konflikti i interesit, deklarimi dhe kontrolli i pasurisë, transparencës e pasurisë, aktivitetin jashtë parlamentar të deputetit, dhuratat dhe kufizimet, transparencën e veprimtarisë parlamentare të deputetit etj..

Neni 1 përshkruan qëllimin e Kodit për t'i ndihmuar deputetët të ushtrojnë detyrën e tyre *“duke përcaktuar rregullat sipas standardeve të duhura të sjelljes gjatë ushtrimit të mandatit të tyre”* dhe *“duke garantuar transparencë dhe përgjegjësi për të rritur besimin e publikut”*.

Neni 2 thekson se *“Kodi zbatohet për deputetët në të gjitha aspektet e jetës së tyre publike dhe nuk rregullon aspekte të jetës private”*. Më tej po ky nen parashikon se *“Rregullat konkrete dhe të detyrueshme për tu zbatuar nga deputetët janë po ato të përcaktuara në ligje të tjera të posaçme si: Ligji “Për statusin e deputetit”, ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, “Kodi penal” etj.*

Neni 3 parashikon parimet e përgjithshme të etikës që duhet të ketë parasysh deputeti gjatë ushtrimit të mandatit duke theksuar interesat të cilave deputetët duhet tu shërbejnë.

Neni 4 përcakton konfliktin e interesit si *“gjendje e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të deputetit, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike”*. Gjatë ushtrimit të mandatit, deputeti i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin për konfliktin të interesave.

Neni 5 përcakton se *deputeti nëse ndodhet në një situatë konflikti interesi plotëson deklaratën të cilën e dorëzon në shërbimin përgjegjës për deputetët*. Ky i fundit mban një regjistër të veçantë për këto raste.

Neni 6 përcakton se *rregullat për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë parashikohen në legjislacionin përkatës*.

Neni 7 përcakton kufizimet e deputetit gjatë ushtrimit të mandatit, për pozicionin, aktivitetin dhe pronësinë, të cilat janë të ndaluara për deputetët. Këto kufizime parashikohen në mënyrë të detajuar edhe në ligjin për konfliktin e interesit.

Projektkodi i propozuar parashikon rregulla në lidhje me dhuratat dhe përfitimet e tjera të ngjashme duke përcaktuar në nenin 8 se deputeti nuk mund “të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat”. Një përcaktim i tillë parashikohet edhe në ligjin për konfliktin e interesit.

Projektkodi i propozuar në vendosjen e këtyre rregullave ka mbajtur parasysh traditën dhe zakonet morale të sjelljes së shoqërisë sonë, prandaj parashikon edhe rregullin se cilat nuk konsiderohen dhurata në kuptimin e kufizimit të marrjes së tyre. “Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të përfitimeve të padrejta për shkak të pozicionit, dhuratat, të cilat i ofrohen deputetit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si deputet”. Gjithashtu, kufizimet në pranimin e dhuratave nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes brenda kufijve normalëtë traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme të cilat nuk krijojnë dyshime mbi mënyrën e ushtrimit të detyrës së deputetit. Projekti parashikon krijimin e regjistrit të dhuratave i cili administrohet dhe përditësohet nga shërbimi përgjegjës.

Projekti i propozuar mban në konsideratë edhe background-in profesional të deputetëve, prandaj parashikon se cilat janë veprimtaritë jashtëparlamentare të deputetit duke përcaktuar “çdo lloj veprimtarie që deputeti zhvillon jashtë ushtrimit të funksionit të tij zyrtar”. Veprimtaritë jashtëparlamentare propozohet të regjistrohen në një regjistër të veçantë, i cili do të administrohet nga shërbimi përgjegjës.

Neni 10 dhe neni 11 përcaktojnë rregullat e sjelljes së deputetit në Kuvend. Projekti i propozuar përsa i përket rregullave të sjelljes në Kuvend, në kuptimin e ngushtë të saj, paraqet një risistemim të përcaktimeve të Rregullores së Kuvendit për këtë çështje. Projekti risjell në vëmendjen e deputetëve dhe rregullat mbi paraqitjen me veshje zyrtare, përdorimin e telefonisë së lëvizshme dhe ndalimin e pirjes së duhanit gjatë zhvillimit të punimeve të Kuvendit, apo në mjediset e tij.

Neni 12 i projektit përcakton se gjatë ushtrimit të mandatit të tij, deputeti duhet të jetë transparent në komunikimin me zgjedhësit, me median dhe me publikun. Byroja e Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi për çdo deputet në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj. Këto shpenzime mund të përfshijnë: pagën, dietat, karburantet, shpenzimet e telefonit, të strehimit, etj.

Projektkodi, në nenet 13 dhe 14 vendos disa kufizime për deputetët edhe pas mbarimit të mandatit përsa i përket mospërdorimit të informacioneve konfidenciale të marra gjatë kryerjes së detyrës për interes personal apo mosushtrimin e avokatisë deri në 3 vjet pas mbarimit të mandatit, për çështje ku Kuvendi është palë ose subjekt i interesuar.

Në lidhje me mënyrën e hartimit dhe miratimit të këtij Kodi propozohet që ai të paraqitet si aneksi 2 i Rregullores së Kuvendit, në mënyrë që rregullat e parashikuara të bëhen pjesë e saj.

Kjo vjen në përputhje me nenin 75, pika 2 të Kushtetutës sipas së cilës “Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve“. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij Kodi propozohet të jetë Byroja e Kuvendit.

- SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I PROJEKTKODIT TË PROPOZUAR

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në mbledhjen e datës 17 tetor 2017 u njoh me projektin e paraqitur.

Anëtarët e opozitës në Këshill u shprehën se: “Projekti i propozuar nuk është aspak premtues për të ezauruar lëndën që merr përsipër të trajtojë, pasi ai në vetvete përmban vetëm 16 dispozita. Rregullat e sjelljes, të cilat profilizohen si rregulla që duhet të disiplinojnë veprimtarinë e përditshme të deputetit, do duhet të jenë relativisht të shumta në numrin e hipotezave që trajtojnë. Nga një sintezë ekstreme e përmbajtjes së këtyre dispozitave rezulton se kodi shfaq një digresion të madh në përmbajtjen e tij. Qëllimi i deklaruar i tij është të parashikojë dhe të disiplinojë sjelljen e deputetëve për lëndë, të cilat nuk trajtohen nga aktet e tjera (rregulloret, ligjet etj.). Në konkluzionin paraprak të analizës, në aspektin formal dhe në atë të teknikës legjislative, projektakti paraqet defekte serioze. Gjithashtu ky rregullim është i pamjaftueshëm, joracional dhe joproporcional për funksionimin e parlamentit dhe nuk është aspak në standardet ndërkombëtare. Zgjidhjet do të ishin parashikimet e qarta, të strukturuar me koncepte të qëndrueshme, bazuar në standarde kushtetuese dhe në mekanizma efektive që do të bënin të mundur pastrimin e plotë të parlamentit aktual nga deputetë me rekorde kriminale, deputetë që janë suportuar në fushatën elektorale nga bota e errët e kriminit, persona me të shkuar kriminale, deputetë, që kanë përdorur fonde, para të kriminit të organizuar, apo deputetët, që kanë lidhje familjare me krimin e organizuar.

Problem tjetër është parashikimi i një organi, një instrumenti, që do të garantojë zbatimin rigoroz, të paanshëm dhe efektiv të këtij kodi, me një rol substancial të opozitës, bazuar në praktikat perëndimore”.

Anëtarët e mazhorancës në Këshill, ndër të tjera u shprehën se: “Nevoja për të pasur një kod sjelljeje është e përcaktuar qartë në nenin 40 të Rregullores së Kuvendit, ku thuhet që deputetët e Kuvendit të Shqipërisë veprojnë në bazë të kodit të sjelljes. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe Komiteti i Ministrave kanë miratuar disa rregulla dhe disa rekomandime lidhur me rolin e parlamentarëve qoftë për gjuhën e urrejtjes, qoftë për parandalimin e racizmit, diskriminimit, qoftë për barazinë gjinore. Konventa e Stambollit na ngarkon me disa detyrime si parlamentarë për rolin aktiv të parlamentarëve në parandalimin e dhunës gjinore. Kemi rregulla të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve që ka një kapitull të veçantë për rolin e parlamentarëve. Rregullorja e Kuvendit nuk ka rregulla të tilla për sjelljen etike të parlamentarëve, si duhet të sillen konkretisht për këto kategori të posaçme, sepse këto detajohen në kodin e sjelljes.

Projekti që propozohet është një përpjekje e rëndësishme për të ndërtuar besimin e publikut tek parlamenti, për të forcuar integritetin dhe transparencën në sistemin e qeverisjes dhe për të konsoliduar institucionet kombëtare demokratike. Projekti i paraqitur vërtet ka 16 nene, por është parashikuar, si shtesë e Rregullores së Kuvendit dhe nëse ka nevojë për shtesa të mëtejshme mazhoranca është e gatshme për këtë. Anëtarët e mazhorancës theksuan nevojën imediate dhe rëndësinë e miratimit të një kodi sjelljeje për deputetët pasi edhe në takimet me ndërkombëret, kjo është një çështje e diskutuar të cilës duhet t’i jepet prioritet”.

Në përfundim të mbledhjes, Këshilli vendosi:

- a) depozitim nga deputetë/te ose grupe parlamentare i amendamenteve për ta përmirësuar më tej variantin e propozuar;
- b) caktimin e relatorëve: Vasilika Hysi, Nasip Naço dhe Enkelejd Alibeaj;
- c) varianti i paraqitur t'i dërgohet Këshillit të Europës dhe OSBE/ODIHR për të shprehur opinionet për këtë çështje.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin u rimblodh në datën 19 Janar 2018 për të vazhduar me diskutimin në parim, shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektit të paraqitur.

Në këtë mbledhje u bënë të njohura amendamentet e depozituara nga deputetja Nora Malaj si dhe komentet e rekomandimet për ndryshime të hartuara nga z. Quentin Reed, ekspert i Këshillit të Europës që funksionon në kuadër të Programit të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë "Departamenti i Aksionit kundër Krimin Ekonomik në Shqipëri (AEC-AL)".

Konkretisht u morën në konsideratë rekomandimet si më poshtë:

Lidhur me organizimin dhe emërtimin e neneve të projektkodit - rekomandimi si vijon:

Riorganizoni dhe emërtoni nenet e Kodit (duke marrë në konsideratë rekomandimet e tjera të cilat do të bashkonin nenet 7 dhe 9, si dhe 10 dhe 11) si vijon: Kapitulli I (Dispozitat e Përgjithshme), Kapitulli II (Sjellja në Kuvend), Kapitulli III (Konflikti Interesit dhe Deklarimi i Pasurisë), Kapitulli IV, (Transparenca dhe mbrojtja e informacionit të fituar gjatë detyrës), "Kapitulli V (Zbatimi dhe mbikëqyrja)

Lidhur me nenin 1 - rekomandimi si vijon:

1. Përcaktoni qëllimin e Kodit, në mënyrë të tillë që ai të:

- a) *Mbledhë/përfshijë të gjitha detyrimet ekzistuese të deputetëve lidhur me sjelljen, në mënyrë që këto detyrime të bëhen më të lehta për t'u kuptuar dhe që ato të interpretohen sipas qëllimit të tyre (frymës).*
- b) *Ti mundësojë deputetëve të zgjedhin drejtimin e duhur të sjelljes në situata të ndryshme të dilemës etike.*
- c) *Të sigurojë një instrument me të cilin deputetët të mund të mbrohen ndaj presioneve të pahijshme.*
- d) *Për të përforcuar një kulturë të integritetit dhe sjelljes së mirë në Parlament.*

Lidhur me nenin 2 - rekomandimi si vijon:

-Ndryshoni nenin 2.1 duke e formuluar si vijon: "Kodi nuk rregullon sjelljen e deputetëve në jetën e tyre krejtësisht private dhe personale apo sjelljen e tyre në role të tjera publike, përveç rasteve kur sjellja dëmton dukshëm reputacionin dhe integritetin e Kuvendit ose të deputetëve në përgjithësi."

-Konsideroni shtimin e një neni që përshkruan detyrat e deputetëve në lidhje me kohën e shpenzuar në Kuvend ose kushtuar detyrave parlamentare.

Lidhur me nenin 3 - rekomandimi si vijon:

Hiqni nenin 3.dh) dhe riformuloni nenin 3.b si vijon: “të veprojnë në interes të popullit në përgjithësi, në interes të zonës së tij/saj zgjedhore dhe në marrjen e vendimeve të udhëhiqet nga interesi i gjerë publik”

Lidhur me nenin 4 - rekomandimi si vijon:

-Ndryshoni Nenin 4.1 duke e formuluar si vijon: “Konflikti i interesit është situata kur një zyrtar është subjekt i një interesi privat që mund të ndikojë në kryerjen siç duhet të përgjegjësisë dhe detyrave publike”.

-Bashkoni nenet 4.3 dhe 6.2.2 në një Nen që përsërit detyrimet e deputetëve për të paraqitur deklarin e interesave private, pasurisë dhe të ardhurave.

Lidhur me nenin 5 - rekomandimi si vijon:

Shtoni fjalitë e mëposhtme në nenin 5.1: “Deputetët mund të dorëzojnë deklaratën gojarisht në fillim të seancës përkatëse parlamentare, përpara ndërhyrjes së parë të deputetit rreth çështjes në diskutim në sallën e seancave të Kuvendit dhe, në rastin e mbledhjeve të komisionit, para diskutimeve rreth çështjes. Deklarimet e tilla duhet të regjistrohen me shkrim nga personi përgjegjës për regjistrimin e procedurave dhe t'i dorëzohet Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve. Kur një deputet/e paraqet raportin e ligjeve të propozuara apo ndryshimeve në ligje, në çdo fazë të procedurës, dhe ai/ajo është subjekt i një interesi që mund të ndikohet nga dispozitat në fjalë, duhet t'i deklarojë ato me shkrim dhe t'i dorëzojë tek Shërimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve.”

Lidhur me nenin 6 - rekomandimi si vijon:

Shtoni një nën-dispozitë në nenin 6 duke përcaktuar se kur deputetët dorëzojnë deklarin e tyre të pasurisë tek Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve, ata informojnë Shërbimin nëse pranojnë që deklarimi të publikohet në internet me të dhënat e redaktuara në të njëjtën mënyrë si deklarimi që jepet nga Inspektoriati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI). Për deputetët që japin pëlqimin, Shërbimi duhet të publikojë deklarinet në faqen e internetit të vetë Kuvendit, të redaktuar siç duhet, ose duke marrë deklarinet nga ILDKPKI dhe t'i publikojë ato.

Lidhur me nenin 7 - rekomandimi si vijon:

Ndryshoni tekstin e Neni 7 duke u etiketuar si Neni 7.1, dhe shtoni nenet e mëposhtme:

a. Neni 7.2: “Pronësia aktive nënkupton ushtrimin e plotë të të gjitha të drejtave që rrjedhin nga pronësia, aksionet ose pjesë të kapitalit. Një organizatë fitimprurëse ka një pozitë dominuese në treg nëse Autoriteti i Konkurrencës e ka vlerësuar se ka një pozitë të tillë. Kur Parlamenti apo ndonjë prej organeve të tij është i mendimit se një kompani në të cilën një deputet ka aksionet ose kapital duhet vlerësuar nëse ka një pozitë dominuese në treg ose jo, Kuvendi, mund të kërkojë nga Autoriteti i Konkurrencës të kryejë një vlerësim të kompanisë.”

b. Neni 7.3: “Nëse aksionet ose pjesët e kapitalit regjistrohen në emër të një të afërmi, që do të thotë bashkëshortit, bashkëjetuesit, fëmijët e rritur, prindërit e zyrtarit dhe ato të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit, ato konsiderohen të njëjtë sikur të ishin të regjistruar në emër të vetë zyrtarit dhe të drejtat për pronën të të afërmeve kufizohen në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit.”

Lidhur me nenin 8 - rekomandimi si vijon:

- Shtoni një nën-paragraf pas nenit 8.1, të formuluar si më poshtë: “Dhuratat, favorët, premtimet ose trajtimet preferenciale të siguruara ose të ofruara për një deputet duhet gjithmonë të konsiderohen se i janë ofruar atij/asaj në lidhje me pozicionin e tij/saj, përveç rasteve kur janë përjashtuar në mënyrë specifike nga kriteret e parashikuara në Nenin 8.4.”
- Hiqni Nenin 8.5 dhe ndryshoni nenit 8.4 si më poshtë: “Dhuratat që deputeti merr nga anëtarët e familjes (bashkëshorti/tja dhe bashkëjetuesi/sja, fëmijët e rritur, prindërit e zyrtarit/res dhe ato të bashkëshortit/tes dhe bashkëjetuesit/ses) nuk konsiderohen si dhuratë në kuptimin e Nenit 8.1, përveç rasteve kur ato janë dhurata të ofruara në mënyrë indirekte nga dikush tjetër. Gjithashtu, dhuratat e zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratat me vlerë simbolike ose mirësjelljeje, brenda kufijve normal të zakoneve tradicionale, të cilat nuk ngrenjë dyshime lidhur me kryerjen e paanshme të detyrës nga ana e deputeti, gjithashtu nuk duhet të konsiderohen si dhurata në kuptim të Nenit 8.1. Në këtë nen do të aplikohen edhe akte të tjera nën-ligjore të Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe të Konfliktit të Interesit që kanë lidhje me dhuratat.”

Lidhur me nenin 9 - rekomandimi si vijon:

Shqyrtoni shtimin në nenin 9 (ose në nenin 7, në qoftë se të dy nenet shkrihen, shih Rekomandimin 7) të nën-neneve të mëposhtme:

- a. “Një deputet duhet të shmangë kontaktet e jashtme që mund të dëmtojnë një vëzhgim objektiv të besimit në punën e tij të drejtë.”
- b. “Një deputet duhet të shënojë në një procesverbal çdo takim me palët e jashtme të cilët i shërbejnë atij për të lobuar në një çështje specifike, si një masë politike ose legislative.”

Lidhur me nenin 10 - rekomandimi si vijon:

Riemërtoni nenin 10.1 ashtu si nenin 10.2 (me nënparagrafë të tjerë që rinumërohen në përputhje me ndyshimet), dhe vendosni një nen 10.1, të formuluar si më poshtë:

“Deputetët duhet të sillen në të gjitha punimet e Kuvendit (si seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve) me dinjitet dhe respekt për deputetët e tjerë, në mënyrë të tillë që të mbështesin reputacionin e mirë të Kuvendit dhe të mbajnë marrëdhënie profesionale dhe kolegiale me stafin e parlamentit dhe personat e tjerë të angazhuar në punimet parlamentare.”

- Zhvendosni Nenet 11.1 dhe 11.2 (për veshjen me rroba formale dhe për mospërdorimin e telefonave celularë) në Nenin 10.4 dhe 10.5, duke hequr kështu Nenin 11.

Lidhur me nenin 12 - rekomandimi si vijon:

Shtoni nën paragrafë në nenin 12, të formuluar si më poshtë:

- a. “Një deputet duhet të ushtrojë të drejtat e tij në Kuvend me transparencë maksimale. Në veçanti, çdo propozim ligjor i paraqitur prej tij/saj në çdo fazë të procedurës legislative, çdo kontribut tjetër në vendimet politike ose në vendime të tjera të marra në Kuvend (si vota në procedurën e emërimit ose në një komision hetimor) gjithmonë duhet të shoqërohet me një justifikim të qartë.”
- b. “Deputetët duhet të japin pëlqimin për publikimin në faqen e internetit të Kuvendit të deklaramit të pasurisë së tyre.”

Sqaroni në Nenin 12.1 atë çfarë nënkuptohet me të qënurit “transparent në komunikimin me votuesit, mediat dhe publikun.”

Lidhur me nenin 14 - rekomandimi si vijon:
Hiqni nenin 14.

Rekomandime të tjera:

- *Vendosni dhe specifikoni në Kod një mekanizëm me anë të të cilit mund të parashtrohen ankesa lidhur me shkeljet në Kodin e Sjelljes dhe me anë të të cilave Kuvendi mund të vendosë sanksione ose të paktën çensurë.*
- *Pas miratimit të Kodit, hartoni një Udhëzues të detajuar për Kodin e Sjelljes*

Projekti pasqyron pjesëm më të madhe të komenteve të paraqitura nga eksperti i Këshillit të Europës. Lidhur me mekanizmin për të trajtuar ankesat për shkeljen e Kodit të Sjelljes ngarkon Buronë e Kuvendit për zbatimin e kodit të Sjelljes.

Në vlerësimin tonë, rregullimi i procedurës së trajtimit të ankesave për shkelje të Kodit të Sjelljes mund të bëhet mes rregullimeve në seksionin që rregullon masat disiplinore, të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit. Argumenti është se Kodi i Sjelljes është shtojca nr. 2 e Rregullores së Kuvendit. Kjo e fundit përmban një kre për shkeljet disiplinore. Është në vlerësimin e Këshillit të rregullores dhe të çdo deputeti të bëjë propozime për përmirësime të mekanizmit të trajtimit të ankesave.

PËRPUTHSHËMRIA E VARIANTIT INTEGRAL QË PARAQITET ME PRAKTIKËN NDËRKOMBËTARE

Varianti integral që i paraqitet seancës plenare për miratim është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për standartet e hartimit të Kodeve të Sjelljes për parlamentarët.

Në diskutimin dhe përmirësimin e projektit të depozituar janë marrë në konsideratë:

- Studimi i OSBE/ODHIR “Standardet etike dhe profesionale për parlamentarët”, Varshavë 2012;
- Përfundimet e Konferencës së OSBE-së “Standardeve e Etikës dhe sjelljes për parlamentarët”, Beograd, nëntor 2011,
- Konferenca e mbajtur në Tiranë në korrik të vitit 2012 me të njëjtën tematikë
- Diskutimet e bëra në një tryezë pune për finalizimin e projektit të Kodit të sjelljes, në Maj 2015 në Kuvendin e Shqipërisë, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Tiranë, pas ekspertizës së ofruar nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në Varshavë.
- Udhëzuesi dhe praktikat më të mira të vendeve si Mbretëria e Bashkuar, Polonia dhe Kodi i Sjelljes së Parlamentit Europian.

Miratimi i këtij Kodi, i cili promovon integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë e deputetëve gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, është edhe një shprehje e implementimit dhe respektimit të standardeve dhe normave ndërkombëtare. Përmendim këtu: Rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1214/2000 për rritjen e konsensusit ndërkombëtar për nevojën e një mekanizmi për deklarimin e interesave në sjelljen parlamentare; Konventa e OKB-së kundër korrupsionit, 2005; Deklarata e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Bruksel 2006, mbi rekomandimet për rregullimin e standardeve profesionale për parlamentarët; etj.

Në kontaktet me organizatat ndërkombëtare dhe në progres raportin e Bashkimit European për Shqipërinë, 2017, faqe 7, miratimi i Kodit të Sjelljes është theksuar si detyrim i pakryer i Kuvendit të Shqipërisë.

- PËRFUNDIMI

Nga anëtarët e Këshillit u vlerësua kontributi i dhënë nga ekspertiza e ekspertit të Këshillit të Evropës, komentet dhe rekomandimet e të cilit u bënë objekt diskutimi dhe u miratuan për t'u reflektuar në përmbajtjen e projektkodit, me qëllim përmirësimin e tij.

Në përfundim, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, gjatë shqyrtimit nen për nen dhe sipas rekomandimeve të ekspertit të Këshillit të Europës, duke mbajtur në konsideratë edhe shqetësimet e opozitës për këtë çështje, miratoi ndryshimet, sipas variantit integral, bashkëlidhur këtij raporti.

RELATORE

VASILIKA HYSI